

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ekonomia drejt fikjes së plotë/ Rritja mbahet me injeksion nga zyrat e shtetit dhe taksat neto
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/ekonomia-drejt-fikjes-se-plote-rritja-mbahet-me-injeksion-nga-zyrat-e-i106581
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 11:39:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 11:32:06 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	06bcfc24aed0bf6643900b00fb212f6f10955d50c12ef6e669af151a1598660
TEKSTI	18842deb9262de36e6f56264d675ff8cb02ecf8525b13f7301c16e8d1bd65c3b
PAMJA	dcf72424e5d0beb10c908fb0c3060bcce236240a6254c5c5684ddfbe7c82065f

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	829688b650a0ee19c35b4e9854c358133e22a1419a73bd48c849631da69e395e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5a00511fec2dd72c79527889eef91c0b757bfc2cb84c819aee6ec0978e94e200
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/829688b650a0ee19c35b4e9854c358133e22a1419a73bd48c849631da69e395e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash:

[me injeksion](#)

[marrin fytirën e titullarit. Në](#)

[Fixhil ishte zëvendësuar](#)

[me miell në një sallë gjyqi në ...](#)

[detajet e para](#)

[informacioneve pa...](#)

[një i plagosur](#)

[paraprake, i plagosuri është](#)

[grupet kriminale](#)

[kurjve tme qe dysohet se përfiton shuma të](#)

[AKTUALITET](#)

Ekonomia drejt fikjes së plotë/ Rritja mbahet me injeksion nga zyrat e shtetit dhe taksat neto

Piranjat Përditësimi i fundit 29 Shtator 2026, 13:32



Ka një shprehje që përdoret shpesh; institucionet marrin fytirën e titullarit. Në fakt, ky është një postulat, i cili mban edhe për ekonominë. Edhe ekonomia e një vendi merr fytirën e atij që e qeveris.

Instituti i Statistikave raportoi se në tremujorin e dytë të vitit, prodhimi i Brendshëm Bruto u rrit me 3.61 për qind i krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Mbi 70 për qind e kësaj rritje erdhi vetëm nga dy sektorë. Ata janë shteti dhe taksat.

Administrimi publik, Arsimi dhe Shëndetësia kontribuan me 1.38 pikë përqindje në rritjen ekonomike të vendit, kurse taksat neto mbi produkte shtuan edhe 1.13 pikë përqindje.

Kjo strukturë rritje, e cila nuk është më episodike por po konsolidohet gjithmonë e më shumë, tregon një të vërtetë të hidhur. Ekonomia shqiptare po fiket. Shqipëria po konsumon dhe po takson, por motori i saj prodhues po fiket përfundimisht.

Shteti dhe taksat si "motorë" artificiale

Peshën kryesore në rritjen reale të vendit e mban sektori "Administrim publik, Arsimi, Shëndetësia". Në fakt shteti nuk prodhon asgjë dhe nuk krijon vlerë të shtuar. Ajo që në librat e PBB-së, shfaqet si rritje ekonomike e ardhur nga sektori publik, nuk është asgjë tjetër veçse rritja e pagave për administratën apo nëpunësit e gjerë të shtetit.

Ky është një rritje e paqëndrueshme, efektet e të cilës shihen shumë shpejt; sapo të kalojë viti i rritjes së pagave, që shuan efekti e bazës. Tremujorin e ardhshëm, qeveria duhet të kërkojë në tjetër vend për rritje ekonomike.

Së dyti, taksat neto janë po ashtu një komponent problematik, i cili zbulon një defekt strukturor në ekonomi. Shteti po mbledh më shumë taksa sepse po rritet volumi i mallrave të importit.

Pra Shqipëria shfaq rritje, thjesht sepse po konsumon më shumë produkte të huaja, duke mbushur arkën e shtetit, por pa krijuar asnjë vlerë të re brenda kufijve. Ky komponent është rezultat direkt edhe i zhvlerësimit të euros ndaj lekut.

Forcimi i kursit të këmbimit i bën importet më tërheqëse ndaj prodhimit vendas dhe rrit volumin e importeve. Kjo ka sjell rritjen e të ardhurave nga taksat dhe efektin e tyre në rritjen ekonomike, por nga ana tjetër edhe një faturë të rëndë. Kolapsin e plotë të sektorit prodhues.

Bujqësia në krizë klinike, industria në amulli

Skaji tjetër i grafikut tregon një realitet dramatik. Bujqësia, pyjet dhe peshkimi shënojnë rënien më të madhe në ekonomi, me një kontribut negativ prej -0,38 pikë përqindje.

Sektori që mban me bukë gjysmën e popullsisë rurale po pëson një turrje të pandalshme, duke braktisur prodhimin e duke ia dorëzuar tregun plotësisht importeve.

Industria (nxjerrëse dhe përpunuese) ka mbetur krejtësisht në vendnumëro, me një kontribut minimal prej vetëm +0,05 pikë përqindje. Pa një industri përpunuese, ekonomia po humbet çdo ditë aftësinë konkurruese dhe fuqinë eksportuese.

ngjerrimi, sektori i cili për disa vite, ka maskuar asgjësimin e prodhimit, duket se po shuhet. Kjo për shkak të bazës tasime të riut, por edhe zmadhimit të uj përtej përmasa normaleve. Rasi u rry për vite me radhë, ndërtimi tashmë në rastin më të mirë nuk mund të fryhet dot më tej.

Shqipëria sot ka një ekonomi që po fiket nga brenda. Nëse ky trend vazhdon, vendi rrezikon të kthehet në një oaz totalisht të varur nga importet, ku paratë e mbledhura nga doganat financojnë një administratë gjithnjë e më të madhe, ndërkohë që fushat mbeten djerrë, ndërsa fabrikat mbyllin dyert./Kapitali.al

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 29 Shtator13:00

[Gjendet një trup i pajetë pranë urës së Farkës, detajet e para](#)

Një trup i pajetë është gjendur ditën e sotme në afërsi të urës së Farkës. Sipas informacioneve pa...

AKTUALITET 29 Shtator12:59

[U zunë për bagëtitë, “plas” thika në Maliq, një i plagosur](#)

Një person është plagosur me thikë në fshatin Sovjan të Maliqit. Sipas informacioneve paraprake, i plagosuri është par...

AKTUALITET 29 Shtator12:39

[Shpërthim i fortë në një pikë karburanti në Sarandë, dy të plagosur](#)

Shpërthim i fortë në një pikë karburanti në Sarandë. Ngjarja ka ndodhur pak minuta më parë në rrugën &l...

AKTUALITET 29 Shtator12:29

[Dosja 'SASPAK', Ilir Beqaj paraqitet në GJKKO](#)

Ish-ministri i shëndetësisë, Ilir Beqaj këtë të martë është paraqitur në ambientet e GJKKO-së lidhur me...

AKTUALITET 29 Shtator12:22

[Lëvizi me makinë në trotuar dhe e postoi në TikTok, gjobitet me 60 mijë lekë dhe i hiqet leja e qarkullimit...](#)

Është ndëshkuar me 60 mijë lekë këtë të martë një qytetar në Berat, pasi me automjet ka lëvizur n&...

AKTUALITET 29 Shtator11:53

[Të shtëna me armë zjarri gjatë një operacioni antidrogë në Qafështamë](#)

Të shtëna me armë zjarri janë regjistruar gjatë një operacioni antidrogë në ditën e sotme në Qafështam&...

AKTUALITET 29 Shtator11:39

[Kapja e 22 tonëve kokainë/ Mediat e Ekuadorit: Mafia shqiptare tentoi të korrupronte agjentë të inteligjencës](#)

Që nga viti 2009 ka gjurmë publike të mafies shqiptare në Ekuador. Një nga figurat kriminale më të ekspozuara ishte Dritan ...

AKTUALITET 29 Shtator11:28

[SPAK i thotë "JO" Veliajt për pjesëmarrjen në mbledhjen e Këshillit Bashkiak](#)

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, nuk do të marrë pjesë në mbledhjen e sotme të Këshillit Bashkiak, e...

AKTUALITET 29 Shtator11:18

[Jep dorëheqjen kreu i Fondit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, ja kush pritet të marrë drejtimin](#)

Ilir Topi ka dhënë dorëheqjen nga detyra e drejtorit të Fondit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, ndërsa ...

AKTUALITET 29 Shtator10:03

[“Fituesi i paracaktuar”, a po kthehet KQZ pas AKSHI-t në “hotspotin” e ri të skandaleve me tenderët?](#)

Me afrimin e zgjedhjeve lokale, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po shton prokurimet për shërbimet që lidhen me administrimin e zgjedhjeve, nga m...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 28 Shtator

[VIDEO tronditëse/ Oficeri i policisë në pension...](#)

Ali Sekeroğlu kishte bërë thirrje për pjesëmarrje në një demonstratë kundër pensioneve të pamjaftueshme, përme...

BOTA 28 Shtator

Krimi horror/ Pedagogia 'Satana' copëtoi trupin...

Është Nicole Formichetti, 46 vjeçe, pedagogia që jetonte në apartamentin në rrugën "Tommaso Gulli" në Tori...

AKTUALITET 28 Shtator

Humbën jetën anëtarët e familjes shqiptare, zba...

Rrjedhja e gazit natyror që shkaktoi shpërthimin me shumë viktima në një ndërtesë në Plaka nisi nga apartamenti i katit ...

Piranjat News INVESTIGIME 29 Shtator11:57

"2200 euro për person, kesh çdo ditë"/ Zbulohet skema si grupet kriminale rekrutojnë shoferët për transportin e emigrantëve ilegalë

Një rrjet i organizuar që vepron përtej kufijve dhe që dyshohet se përfiton shuma të konsiderueshme nga trafikimi i emigrant&eum...

video




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2




PIRANJAT SHOW - SEZONI 10 EPISODI 2



Nga burgu në arrest shtëpie: Eduard Limaj rikthehet te përndjekja e grave!





Haris Vongli: Dua të kthehem në Shqipëri për Davidin, tim bir.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.